

Model i hapave integruese evropiane të qeverisjes vendore



NJOFTIM

Gendra e biznesit Kamëz organizon nga data 15-18 prill 2010 panairin e parë të biznesit në Kamëz. Ftohen të marrin pjesë të gjitha bizneset e interesuara. Aplikimi bëhet pranë zyrave të Qendrës së Biznesit në Kamëz. Numër kontakti: 068 20 20 349



Gazetë e Bashkisë Kamëz

KAMZA

Organ i Bashkisë Kamëz
E përdyjavshme
Nr. 47 / Mars 2010
Çmimi: 20 lekë
Tel: 068 60 45 387
gazetakamza@yahoo.com
www.kamza.gov.al

Kamza dhe Macerata tanimë binjake

Perspektiva të reja për Kamzën

"Ajo që është akoma edhe më e prekshme, është aplikimi për fondet e huaja, të cilat bashkia Kamëz përfiton për shkak të këtij binjakëzimi, si qytet dhe pjesë e Bashkimit Evropian."-ka deklaruar kryetari i Bashkisë së Kamzës, z. Xhelal Mziu. Sipas tij, një nga këto projekte është ai projekti i pastrimit të qytetit, ku bashkia e Kamzës, Komuna e Maceratës, Komuna Bushat dhe një komunë tjetër e Malit të Zi kanë aplikuar tek IPA Adriatik, një projekt ky shumë i rëndësishëm, ku bashkia Kamëz pritet të përfitoj një vlerë mjaft të madhe, prej më shumë se 350 mijë euro, i cili do të japë një hov të dukshëm në pastrimin e qytetit.

Sa kohë u bë që kur kanë nisur hapat e parë që do të sillnin firmosjen e marrëveshjes së binjakëzimit?

Binjakëzimi është si një element mjaft i rëndësishëm i emtuar nga Bashkimi Evropian, shërben si një urë lidhëse mes qyteteve të ndryshme për të bërë shkëmbime sociale, kulturore sportive etj. Jo vetëm kaq, por edhe efektet e tjera pozitive që vinë për shkak të këtij binjakëzimi janë të mëdha e me shtrirje të gjerë.

Për t'iu rikthyer pyetjes është një periudhe prej më shumë se dy vitesh që ne po bashkëpunojmë për të arritur tek kjo finale me komunën e Maceratës. Kishim mjaft arsye për ta realizuar këtë binjakëzim. Unë mund t'iu them që Bashkia e Maceratës është në një pozicion gjeografik mjaft të pëlqyer, e përfshirë brenda rajonit Marke. Një qytet historik dhe i vjetër, qytet universitarë, duke pasur dy universitete me një jetëgjatësi më shumë se 500 vjeçare.

Macerata është i ndërtuar me parimin e qytetit kështjellë, me katër dalje. Po ashtu mësuam se para pesë shekujsh, kur shqiptarët të detyruar nga regjimi osman largoheshin nga Shqipëria në drejtim të Italisë, Rajoni i Markes ishte një nga zonat ku përqendroheshin shqiptarët e kryesisht në qytetin e Maceratës. Kontributi i shqiptarëve sigurisht ka qenë në shumë fusha, është interesante të thuhet se murri rrethues i këtij qyteti është bërë pikërisht nga shqiptarët. Po ashtu edhe nga deponime të mjaft personaliteteve që ne takuam, na treguan se është folur shqip në zona të këtij qyteti për një periudhe të gjatë kohore, që nga 1400.

[Vijon në faqen 3]



Intervistë

Lidhja e Shqipërisë me Maceratën është që nga viti 1400



Roli i priftit të kishës së Bathores Don Patricio Santineli në lidhjen me Maceratën

FAQE 6

NË BRENDËSI:

Fjalimet e rastit të z. Meschini dhe z. Mziu në ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes

FAQE 2

Flamuri kuq e zi në sheshin kryesor të Maceratës

FAQE 6

Banka Botërore së shpejti do të fillojë ndërtimin e dy shkollave në "Bathore 5" dhe "Bathore 6"

FAQE 8

Ekipi Kamza sjell emocione në fushë

FAQE 8



binjakëzim

Fjalimet e rastit në ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes

Fjala e z. Meschini, kryetar i Bashkisë së Maceratës



Nënshkrimi i këtij akti të ri binjakëzimi shënon një moment të rëndësishëm për komunitetin tonë. Ai i shtohet marrëdhënieve më të lashta me qytetin gjerman Weiden, me atë francez Issy les Moulineaux e atë më të fundit me qytetin maltez Floriana.

Të gjitha akt-marrëveshjet e binjakëzimit janë të rëndësishme, por besoj se ky i sotmi ka një kuptim të veçantë për disa arsye që do të mundohem të shpjegoj; së pari binjakëzimi me një qytet shqiptar bëhet pak vjet pas disa ngjarjesh që kanë pasur si protagonist dy popujt tanë e që kanë përfshirë edhe qytetin tonë.

E kam fjalën për eksodin që u vërshuan në bregdetin tonë Adriatik në mes të viteve '90 e që pa realizimin e disa qendrave pritjeje, midis të cilave edhe një këtu në Macerata dhe që hapi diskutime e polemika në qytet, sidomos në zonën e caktuar për ndërtimin e kampit. Ishte arratia e një populli që dilte nga një situatë veçanërisht vështirë e që kërkonte një shprehje të re jetese mirënjohje në një vend të njohur nëpërmjet televizionit.

Ndërsa sot festojmë një marrëveshje miqësie e bashkëpunimi me një qytet të këtij vendi që po jeton një zhvillim të ri dhe një mundësi të re pritjeje, qoftë personale qoftë të komunitetit, e me një perspektivë marrëdhëniesh me vendin tonë shumë interesant për të ardhmen e afërt.

Së dyti, ky binjakëzim është i pari me një qytet të një shteti që nuk bën pjesë në Komunitetin Evropian, megjithëse i përket plotësisht kontinentit tonë e në pritje të pranimit të kërkesës; urojmë që ky binjakëzim të sjellë mbarësi e që procesi i pranimit të përfundojë pozitivisht e në një kohë të shkurtër.

Së fundi ky binjakëzim përfundon një udhë të mbështetur fillimisht në marrëdhëniet midis njerëzve të Maceratës e Kamzës, e pastaj atë midis institucioneve; miqësua midis njerëzve i detyrohet prezencës në Kamëz të priftit Don Patrizio Santinelli, i cili, me prejardhje nga dioqeza jonë e sidomos prej disa famullive të qytetit tonë, po zhvillon aktivitetin e tij baritor e social në atë qytet prej disa vjetësh, duke afruar për ta ndihmuar shumë miq nga Macerata, midis tyre edhe vullnetar të Karitas-it dioqezan; është krijuar kështu një lidhje e fortë miqësie e bashkëpunimi.

Në këtë frymë në korrik 2006-ës, së bashku me Ipeshkvin e ri të Maceratës, bëra një udhëtim të parë në Shqipëri gjatë të cilit takova edhe Kryetarin e Bashkisë dhe Administratën e Kamzës, takim që i hapi rrugën marrëdhënieve zyrtare që na sollën në këtë ditë.

Gjatë këtyre viteve janë zhvilluar takime të tjera, jo vetëm midis administruesve por edhe midis funksionarëve të të dy bashkive, që kanë përforcuar vullnetin e bashkëpunimit reciprok e në veçanti mundësinë që eksperiencia e tyre e re administruese të ketë një mbështetje e një shkëmbim eksperiencë me historinë më të gjatë të bashkive italiane, megjithëse duhet të them që kam ndeshur një kapacitet organizues e prije drejt të resë për ta patur zili, ndoshta edhe më të zhvilluar sesa realiteti ynë më i vjetër; siç ndodh shpesh midis situatave më të konsoliduar e pra më konservatore dhe atyre më të reja e që me gatishmëri zotërojnë përparimet; përveç mundësisë së aktivizimit të një eksperiencë partneriteti për përdorimin e fondeve evropiane të drejtuara në mënyrë specifike kundrejt vendeve në pritje të hyrjes në KE si Shqipëria, për transferimin e njohjes dhe të praktikave të mira administruese, siç kemi aktivizuar për shembull kohët e fundit në sektorin e mbeturinave.

Nëse binjakëzimet janë një moment i rëndësishëm për njohjen reciproke e përforcimin e shpirtit evropian që deri tani kemi jetuar me qytete të vendeve që i përkasin KE, në veçanti për rininë, i tillë është akoma më shumë ky midis nesh dhe qytetit të Kamzës: për të kapërcyer njëherë e përgjithmonë paragjykimet e shqetësimet që qyteti ynë ka përjetuar gjatë situatës që përmendëm të disa vjetëve më parë; për një integrim më të mirë të shumë qytetarëve shqiptarë që ndodhen në qytetin tonë (kemi regjistruar mbi 500) e për prezencën më të ndërgjegjshme di disa ndërmarrjeve të rëndësishme për territorin tonë e që tashmë zhvillojnë aktivitete në Shqipëri; për një udhë mirëkuptimi drejt integritetit të plotë në KE si perspektivë e privilegjuar për një të ardhme paqeje e zhvillimi në kontinentin tonë, në një botë gjithnjë e më të vogël e më të globalizuar.

Jam dëshmitar i faktit që qyteti i Kamzës është një realitet me një zhvillim pothuajse të vrullshëm që nga një anë mund të krijohet problem të karakterit social e urbanistik, por nga ana tjetër ju ofron banorëve të vet mundësi rritjeje qoftë ekonomike qoftë personale. Për analogji jam dëshmitar i punës dhe efikasitetit të Administratës e sidomos të kolegut Kryetar i Bashkisë Xhelal Mziu në realizimin e shërbimeve bazë për qytetarët me pikësynimin që t'u ofroj atyre kushtet më të përshtatshme për një bashkëjetesë dinjitoze.

Gjithashtu, jam dëshmitar i vëmendjes dhe konsideratës së lartë që Bashkia Kamëz ka kundrejt aktivitetit social të don Patricio-s që shprehet në iniciativat e shumta e mbi të gjitha në formimin profesional në favor të grave dhe të përfshirjes e mbështetjes së të rinjve në një zonë të qytetit që dallohet sidomos për imigracionin e brendshëm me prejardhje nga zonat më të varfra të Shqipërisë.

Duhet të falënderojmë pra, për rezultatin e sotshëm mbi të gjitha kolegun Kryetar të Bashkisë e gjithë administratën e tij për bindjen dhe vendosmërinë më të cilat kanë realizuar këtë objektiv; po ashtu don Patricio-n që si person e me veprën e tij nuk ka realizuar vetëm kushtet për njohjen e Bashkisë së Kamzës, por ka qenë edhe elementi që me sjelljen e tij krijoi bazat për vlerësimin dhe besimin reciprok.

Së fundi më lejoni një kuriozitet: tre nga qytetet e binjakëzuar me Maceratën kanë një karakteristikë të përbashkët që ndoshta mund edhe të krijohet kushtet për njohjen në të ardhmen; ndodhen të treja brenda rrethit të kryeqyteteve të shteteve përkatëse e më saktë Issy pranë Parisit, Floriana pranë La Valletta e së fundi Kamza pranë Tiranës.

Fjala e z. Mziu, kryetar i Bashkisë së Kamzës



Jam këtu, me emocionet dhe ndjeshmërinë e lartë jo vetëm të qytetarit të parë të Kamzës, por edhe të çdo qytetari shqiptar, në Sallën e Këshillit Bashkiak të Maceratës, në këtë sallë me vlera të shquara historiko politike, në qytetin me tradita të shquara kulturore e universitare, Macerata, së bashku me delegacionin e ardhur nga Shqipëria, që përfaqëson qeverinë lokale të Kamzës dhe qytetarët e nderuar të saj, por edhe me miratimin e Qeverisë Shqiptare, për të marrë pjesë në ceremoninë historike të nënshkrimit të Akt-Marrëveshjes së Binjakëzimit midis dy qyteteve Macerata e Kamza.

Kjo është për mua dhe për të gjithë Këshillin përfaqësues të Kamzës e stafin e saj, për të gjithë komunitetin tonë, një ditë e madhe, një ditë që hap një faqe të re historike, atë të vendosjes së miqësisë e të bashkëpunimit, të shkëmbimit të vlerave civile qytetare midis dy vendeve, popujve dhe komuniteteve tona. Është nder, fat dhe përgjegjësi e madhe që qeverisjet e qytetarëve, që janë votuar dhe gëzojnë besimin e tyre të realizojnë hapa të tilla, që janë vënë sot në rend të ditës dhe me interes të gjerë, siç është nënshkrimi i marrëveshjes së marrëdhënieve të binjakëzimit, si një marrëdhënie me vlera të shumanshme bashkëpunimi e integrimi, jo vetëm midis institucioneve, por sidomos shkëmbim vlerash të përbashkëta historike, arsimore, kulturore, politike, shoqërore midis popujve.

Në këtë moment solemn dëshiroj të falënderoj të gjithë ata që kanë dhënë kontributin e tyre për të arritur në këtë ngjarje të shënuar dhe në radhë të parë të falënderoj Këshillin Bashkiak të Maceratës, Ministrinë e Jashtme dhe Ministrinë e Brendshme të Italisë, Autoritetin e përfaqësimit të Rajonit Marke, Kishën Katolike të Maceratës për vendimarrjen, apo mbështetjen e tyre për Akt-Marrëveshjen e Binjakëzimit. Por një falënderim të veçantë dua të bëj për kolegun dhe mikun tim të dashur z. Giorgio Meschini, i cili së bashku me stafin e tij, ka organizuar e drejtuar gjithë këtë proces përgatitor; që nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Mirkuptimit, konkretizuar me

takime e vizita, korrespondenca të vazhdueshme me axhenda të ndërsjella, për shkëmbimin e ideve e fushave të bashkëpunimit, të projekteve të përbashkëta, duke i bërë tashmë këto marrëdhënie realitet shumë të afërta dhe të prekshme midis dy qeverisjeve dhe qyteteve tona. Këto kontakte përveç aspektit të pashlyer mikpritës dhe tepër miqësor; kanë qenë një nxitje e frymëzimit i madh për ne, për qeverisjen e Kamzës, shoqërinë civile, biznesin, komunitetin, etj. Shprehje e drejtpërdrejtë dhe shume sinjifikative e këtyre marrëdhënieve kanë qenë edhe vendimi i Këshillit Bashkiak të Kamzës për vendosjen e dy emrave "Macerata" dhe "Padre Matteo Ricci", dy rrugëve të reja të Kamzës. Këto hapa të hedhura na kanë dhënë forcë e besim të patundur, se rruga e ndjekur për zhvillimin e Kamzës dhe bashkëpunimin me Maceratën janë paralele që do të zgjaten dhe ecin bashkërisht, sepse Macerata është një shembull e model i progresit evropian dhe një partner i denjë për Kamzën, si qyteti i një vendi me peshë e rol të madh në proceset integruese për Shqipërinë, siç është Italia. Prandaj shpreh bindjen dhe besimin tim te plate, se Akt Marrëveshja e Binjakëzimit që nënshkruajmë sot është me vlera shumëdimensionale, me rëndësi jo vetëm për komunitetet lokale, por edhe për miqësinë midis popujve të Italisë dhe Shqipërisë dhe për më tepër për familjen e përbashkët evropiane.

Ja pse kjo marrëveshje nuk erdhi spontanisht dhe do të ketë jetëgjatësi të madhe, duke i rezistuar kohës, sepse ajo do të ngjizet edhe më shumë me aktivitete të gjithanshme, që do të burojnë nga vullneti dhe dëshira e lirë demokratike e popujve dhe zhvillimet e mëtejshme në Evropë dhe në botë.

Desha të nënvizoja gjithashtu se vullneti pozitiv dhe vendim-marrja e Këshillit tuaj Bashkiak për Akt-Marrëveshjen e binjakëzimit, shpreh me se mirë edhe atë pozicion mbështetës aktiv që Komuna e Maceratës tregon për shqiptarët që jetojnë, studiojnë e punojnë në Macerata, duke dhënë një shembull edhe për të tjerët brenda e jashtë Italisë, për kujdesin ndaj emigrantëve dhe format integruese të tyre.

Një falënderim e konsideratë të lartë mirënjohje, dua të shpreh edhe për mbështetjen e aktorëve të rëndësishëm me veprimtari në Shqipëri që nga Këshilli Bashkiak i Kamzës, Ministria e Punëve të Jashtme, z. T.Preka, Padre Dom Patrizio, Karitasi i Maceratës, Kisha e Bathores etj, që kanë dhënë ndihmesën e pakursyer të tyre, për arritjen e marrëveshjes e bashkëpunimit e të binjakëzimit të qyteteve tona.

Duke përfunduar, ju siguroj se firma ime ne manifestin e binjakëzimit, e përgatitur me aq frymëzim e filozofi nga Komuna Macerata dhe miratuar nga Këshillat Bashkiak të dy qyteteve, është ajo më e rëndësishmja në të gjithë periudhën e mandatit tim, që do të shoqërohet me angazhimin maksimal timin dhe të të gjithë aktorëve të qeverisjes lokale, por edhe qendrore, për zbatimin e çuarjen e saj sa më përpara.

Ju siguroj gjithashtu, se data 13 Mars 2010, do të mbetet në memorien e historisë së Kamzës si data më e rëndësishme integruese evropiane për të dhe Z. Meschini si nismëtar e arkitekti i parë në këtë proces.

Edhe një herë ju faleminderit për mikpritjen dhe për këtë ceremoni kaq të mrekullueshme!

Macerata, 13 Mars 2010



binjakëzim

KAMZA DHE MACERATA TANIMË BINJAKE

Perspektiva të reja për Kamzën

Bisedë me Kryetarin e Bashkisë së Kamzës Z. Xhelal Mziu

(Vijon nga faqja 1)

Çdo të thotë për Kamzën binjakëzimi me Maceratën, cili është impakti, janë përfitimet... ?

Kuptohet që ka qenë një dëshirë e jona, por edhe e atyre, për t'u bërë ky binjakëzim, i cili ka dhënë efektet e tij pozitivë edhe para mbylljes formale të aktit të binjakëzimit. Një delegacion i Bashkisë së Kamzës para një viti vizitoi Bashkinë e Maceratës, e kjo vizitë shërbeu si një mundësi për të marrë eksperiencën e nevojshme të të gjithë shërbimeve, duke filluar që nga urbanistika, tatimet, shërbimet publike, buxheti social etj. Ato gjëra pozitive që kishte implementuar kjo bashki, specialistët e fushave përkatëse të Bashkisë Kamzë, bënë të mundur që të fillonin implementimin e tyre në bashkinë tonë. Përveç kësaj eksperience bashkia jonë përfitoi edhe në mjaft fusha të tjera, në atë kulturore e sociale.

Ajo që është akoma edhe më e prekshme, është aplikimi për fondet e huaja, të cilat bashkia Kamzë përfiton për shkak të këtij binjakëzimi, si qytet dhe pjesë e Bashkimit Evropian. Një nga këto projekte është ai projekti i pastrimit të qytetit, ku bashkia e Kamzës, Komuna e Maceratës, Komuna Bushat dhe një komunë tjetër e Malit të Zi kanë aplikuar tek IPA Adriatik, një projekt ky shumë i rëndësishëm, e bashkia Kamzë pritet të përfitoj një vlerë mjaft të madhe, prej më shumë se 350 mijë euro, i cili do të japë një hov të dukshëm në pastrimin e qytetit. Gjithashtu ne kemi aplikuar edhe për



një projekt tjetër, një projekt social që ka të bëjë me rininë dhe me shtresat e tjera të popullsisë. Ky projekt ka një vlerë të konsiderueshme dhe jam i sigurt që jemi përfitues edhe të këtij projekti, që mban edhe emrin e partneritetit për zhvillim. Të dyja këto projekte janë frytet e para të drejtpërdrejta të marra nga ky binjakëzim. Kuptohet që ky është vetëm fillimi dhe do të kemi të tjera përfitime të dyanshme.

Macerata ishte e binjakëzuar edhe me tre qytete të tjera

përveçse me Bashkinë e Kamzës. Në shtypin vendas njoftoj binjaku i katërt i Maceratës...?

Është e vërtet që ne ishim qyteti i katërt i binjakëzuar. Tre qytete të tjera, një në Francë, në Gjermani dhe me një tjetër në Maltë, ishin të binjakëzuar me Maceratën, por gjatë bisedës që kishim me kryebashkiakun e këtij qyteti, ramë dakord, që të fillojnë edhe marrëdhëniet me këto qytete. Këto marrëdhënie mund të fillojnë si fillim me një aktivitet sportiv, të cilin do ta organizoj Bashkia e

Maceratës. Ky do të jetë një moment që edhe ne të krijojmë ura lidhjeje me këto tre qytete të tjera, pse jo mund të shkojmë edhe më tej, drejt binjakëzimit me këto qytete.

Ne si Bashki jemi në procedurë binjakëzimi edhe me dy qytete të tjera Jena në Gjermani dhe La Plata në Argjentinë. Nënshkrimi i marrëveshjes së binjakëzimit me Maceratën mund të ndikojë në shpejtimin e procesit të binjakëzimit me to?

Nuk janë të rastësishme ose momentale këto tratativa për binjakëzim. Bashkia ka një strategji të saj në shumë drejtime, pse jo edhe në marrëdhëniet ndërkombëtare. Në këtë drejtim ajo ka tentuar për të kryer marrëdhëniet e binjakëzimit me mjaft qytete, ajo e sheh të arsyeshme që ka se çfarë të marrë në aspektin e binjakëzimit dhe në këtë drejtim përveçse Maceratës ne jemi në prag të binjakëzimit edhe me qytetin e Jenës, një qytet universitar, por edhe me qytetin e La Platës në Argjentinë. Në këto dy qytete janë shkëmbyer delegacionet e ndërsjella dhe jemi shumë pranë formalizimit të këtij akti, sidomos me qytetin e Jenës.

Jam i sigurt që brenda pak javësh ose muajsh do të ndodhë procesi formal i binjakëzimit të këtyre dy qyteteve, pse jo edhe me qytetin e largët të La Platës. Ndërkohë ne po punojmë edhe me qytete të tjera për të bërë binjakëzime, sepse e shohim si një instrument mjaft

Një nga këto projekte është ai projekti i pastrimit të qytetit, ku bashkia e Kamzës, Komuna e Maceratës, Komuna Bushat dhe një komunë tjetër e Malit të Zi kanë aplikuar tek IPA Adriatik, një projekt ky shumë i rëndësishëm, e bashkia Kamzë pritet të përfitoj një vlerë mjaft të madhe, prej më shumë se 350 mijë euro, i cili do të japë një hov të dukshëm në pastrimin e qytetit.


të rëndësishëm për shkëmbime jo vetëm eksperiencash, por edhe për përfitime të tjera të drejtpërdrejta që vinë nga ky proces.

A është ky një lloj integrimi konkret në botën e zhvilluar?

Është e vërtet që gjatë këtyre binjakëzimeve në momentet e para edhe për shkak të mos pasjes së informacionit, por edhe të situatës jo aq komode të bashkisë nuk kishim të njëjtin ritëm siç kemi sot. Tani për shkak të këtyre marrëdhënieve që kemi krijuar me këto qytete, jo vetëm kemi lëvizur në drejtimin tonë, në progresin që kemi krijuar këtu krahasuar me të kaluarën, por edhe për shkak të këtyre marrëdhënieve që ne po krijojmë, po kthehemi edhe ne në një partner të kërkuar nga këto qytete e të tjerë. Mund të themi se ambicjet për binjakëzimet kanë qenë të dy anshme për shkak të performancës dhe progresit që ka patur Bashkia Kamzë.

Delegacionet e këtyre qyteteve që kanë ardhur, kanë pasur se çfarë të marrin nga Bashkia Kamzë. Kuptohet se përveçse binjakëzimeve ne kemi tentuar të jemi të pranishëm në arenën ndërkombëtare. Bie fjala, fakti i vendosjes së emrave rrugëve në adresarin e Bashkisë sonë, ku një numër i konsiderueshëm janë emra të njohur ndërkombëtar, kanë shërbyer si një urë lidhëse midis bashkisë dhe atyre institucioneve, personaliteteve apo qyteteve që ne kemi vënë emrin. Në shkëmbimet e letrave që kemi pasur me ato, kemi marrë falënderimet e tyre jo vetëm për Kamzën, por edhe për Shqipërinë, për politikën qeverisëse të vendit.

Bisedoi: Z.Elezi





reportazh

EMOCIONE DHE NGROHTËSI

Kamza binjakëzohet

Dy vjet të shkuara filluan përpjekjet e para për një lidhje të mundshme me një Komunë të Rajonit të Markes në Itali, Maceratën. U bënë hapa të shumtë e bisedime me aktorë e persona të shumtë që Kamza të kishte mundësi marrëdhënie me një qytet të vendeve të zhvilluara evropiane. Ky ishte një pikësynim i vetë liderit të Bashkisë Z. Mziu, i cili nuk reshti për asnjë çast së kërkuari e investuari në këtë drejtim.

Me punë këmbëngulëse e projekte të qarta vijmë në momentin final dhe delegacioni i Bashkisë Kamëz udhëton drejt aeroportit të Rinasit me axhendë të precizuar deri në detaje. Misioni i delegacionit është kontribut i madh në rrjedhën e historisë të qytetit të ri të Kamzës, këtij qyteti në formim e sipër. Dita e shënuar për nënshkrimin e marrëveshjes së Binjakëzimit erdhi, ndaj ky delegacion nuk ishte i radhës, por ai që do të realizonte momentin historik, firmosjen e marrëveshjes.

Avioni çan përmes reve në drejtim të bregut tjetër të Adriatikut. Kujdesemi të mos harrojmë asgjë, gjithçka të realizohet sipas parashikimeve në axhendën e hartuar me miratimin e të dyja palëve.

Në aeroportin e Ankonas na priste një minibus i dërguar posaçërisht për delegacionin e Kamzës. Udhëtojmë drejt Maceratës, qytet i vogël prej afro 45 mijë banorësh, por me një histori shumë të vjetër. Qytet universitar. Universiteti i Maceratës u themelua në vitin 1290 dhe ka rreth 13.000 studentë. Ajo që të bie në sy që në krye të herës, është arkitektura dhe koncepti urban i ndërtimit të qytetit. Qyteti është i dekoruar me ndërtesa të tilla si Pallati Buonaccorsi i ndërtuar posaçërisht për Kontin Raimondo Buonaccorsi me mure e salla të pikturuara me afreske nga mjeshttrat e rilindjes së famshme italiane.



Darkë pune

Macerata e ndërtuar sipas parimit "qytet kështjellë" me murrin rrethues, i cili është ndërtuar nga shqiptarët e shkuar atje në vitet 1400, në kohën e pushtimit osman.

Me një takim në Universitetin e Maceratës filloi dita e parë e plotë në Macerata. Në prani të profesorëve e studentëve që kishin mbushur sallën

e konferencave të universitetit, nga studiues e hulumtues të Maceratës u mbajtën disa kumtesa e studime për zonën e Bathores. Ajo që të ngelej në mendje nga ky takim ishte serioziteti e kompetenca në analizën e shtrimit e problemeve.

Emocione të forta e të paharruara u krijuan në momentin e

dhënies nga Z Mziu, të lejes së ndërtimit për Kishën në Bathore, lëshimit të Maceratës **Z. Claudio Giuliodori. Surpriza ishte dhe për Don Patricion, priftin e Bathores, pasi as ai nuk dinte për miratimin e lejes së ndërtimit. lëshimi krijoi një atmosferë të vërtetë festive kur hapi një shishe shampanje pesë litroshe, duke i dhënë takimit ngjyra të pa imagjinuara. Me thjeshtësi dhe elegancë ai na shërbeu vetë të gjithëve. Momente të paharrueshme.**

"Ditën e shtunë në ora 10.30 në sallën e Këshillit Bashkiak zhvillohet ceremonia e nënshkrimit të marrëveshjes së Binjakëzimit me Bashkinë e Kamzës", njoftonin postera të shumtë të shpërndarë nëpër qytet. Emocionin që përcillnin këto njoftime e shihje më së miri në portretet e studentëve shqiptarë që vazhdonin studimet në Universitetet e Maceratës, në fytirat e

emigrantëve tanë që punonin e jetonin atje, e që kishin ardhur të përjetonin emocionet e firmosjes së marrëveshjes. Dukshëm shihet kjo tek të gjithë. Dukej sikur qyteti e kish këtë moment një çast të madh e të bukur, një moment të shumë pritur.

E gjithë atmosfera në qytet fliste për këtë ngjarje, deri në detaje e menduar, me thjeshtësi, por me një kujdes që të mbetej në kujtesë. Gjithçka e menduar më mirë, organizuar me përpikmëri, deri edhe në përzgjedhjen e të ftuarve që mbushnin sallën e Këshillit Bashkiak. Njerëz të rëndësishëm në jetën e Maceratës, profesorë, politikanë, personalitete të fesë, përfaqësues të biznesit e studentë shqiptarë që vazhdonin studimet në universitetet e Maceratës, pjesëtarë të stafit të Bashkisë së Maceratës e të tjerë që mbushnin sallën shpërthyer në duartrokitje kur në podium zunë vend dy liderët e bashkive përkatëse.

Pas fjalimeve të rastit u nënshkrua jo thjeshtë një marrëveshje por një akt i rëndësishëm në jetën e dy qyteteve, në marrëdhëniet mes dy popujve.

"Në këtë ditë marrim solemnisht angazhimin të vendosim dhe të mbajmë marrëdhëniet të vazhdueshme ndërmjet administratave tona, por mbi të gjitha ndërmjet popujve tanë përkatës, me qëllimin për të arritur një mirëkuptim reciprok me të mirë, një bashkëpunim efikas, një ndjenjë të thellë për fatin tashmë të përbashkët, e kështu, një ndihmë reciproke në përbashkëpunimin e problemeve administrative, ekonomike, sociale e kulturore, duke zhvilluar solidaritetin dhe pjesëmarrjen e të gjithë atyre që jetojnë e punojnë në komunitetet tona; të bashkojmë përpjekjet tona për të mbështetur me të gjitha mjetet suksesin e kësaj nisme, vazhdimësinë e këtyre lidhjeve paqeje e prosperiteti."



Vizita në kështjellën e Tolentinos



Duke vizituar pallatin e Kontit Raimondo Buonaccorsi



Bisedimet e zhvilluara në Universitetin e Maceratës



me Maceratën

Kur i lexon këto rreshta të shkëputura nga teksti i marrëveshjes së Binjakëzimit, menjëherë kupton rëndësinë e këtij bashkëpunimi, qëllimin fantastik e atë ç'ka pritet të ndodh në të ardhmen e afërt, atë ç'ka pritet të realizohet në ditët në vazhdim.

Shkëmbime dhuratash nga të dyja palët, emocione dhe përgëzime pa fund. Fjalë të ngrohta e konsiderata do shprehte shtypi i shkruar i Rajonit të Markes, i qytetit të Maceratës që para nënshkrimit të marrëveshjes dhe pas saj.

Në diskutimet e ndryshme të zhvilluara për gjatë tre ditëve të qëndrimit në Macerata, në bisedat e shumta të zhvilluara ndërmjet të dy përfaqësuesve të Bashkisë, Meschini e Mziut, u shpalesën mjaft ide e projekte që do të startojnë në muajt e ardhëm, bie fjala, ideja e



Shtrëngim duarsh me Ispshkin Z. Claudio Giuliodori

mikpritës. Ngado të hidhe sytë shihje pafund toka të sistemuara e të punuara me kujdes të madh. Peizazhe të mrekullueshëm, që flisnin për kulturë e të krijonin një ndjesi tejet për t'u admiruar. Kemi se ç'të marrim nga ky rajon, i cili konsiderohet si një nga rajonet më të rëndësishëm të Italisë.

Gjatë gjithë kohës ishim të shoqëruar e të asistuar nga punonjësit e Bashkisë së Maceratës, ishim nën kujdesin e tyre që gjithçka të shkonte sipas parashikimit. Thjeshtësia e sinqeriteti i Z. Meschini e çlironte gjithë bisedën dhe së bashku me Z. Mziu, bënë që kjo vizitë përveç arritjes së objektivit madhor, nënshkrimit të aktit të binjakëzimit, të kalonte në situata të shkëlqyera marrëdhëniesh të ndërsjella. Ishim dëshmitarë të një humori të hollë e shumë të pranishëm në të gjitha drekat e darkat e shtruar me bujari nga miqtë italianë.

Kjo atmosferë e ngrohtë e vëllazërore e shoqëroi për gjatë gjithë kohës delegacionin deri në momentin e përcjelljes e të shtrëngimit të duarve ku nuk mungonte edhe Znj. Meschini, duke i dhënë takimit intimitet e ngrohtësi të veçantë.

Gjatë gjithë kohës u ndjemë si të njohur prej shumë e shumë vitesh, ndjeheshim si në shtëpinë tonë, kjo si pasojë e atmosferës së krijuar nga miqtë e Maceratës.

"Me konsideratën time më të lartë për Bashkinë e Maceratës dhe të kolegut tim Georgio Meschini"-do shkruante Z Mziu në librin e përshtypjeve ku kishin lënë mbresat e tyre personalitetet e rëndësishme që kishin vizituar Maceratën.

Kjo atmosferë shpeshojmë që të vazhdojë e sa më shpejt të marrin jetë projektet e nënshkruara e diskutuara në mes palëve.

Z. Elezi



Posterat që njoftonin binjakëzimin në rrugët e Maceratës

hedhur nga Meschini për zhvillimin e një turneu futbollit në mes të rinjve jo vetëm të Kamzës e Maceratës por edhe me dy qytete e tjera të binjakëzuara me Maceratën, Weiden in der Oberpfalz, Gjermani, Issy-les-Moulineaux, Francë dhe Floriana, Maltë.

Pra ky është vetëm fillimi i një tjetër zhvillimi të Kamzës, mund dhe duhet të themi pa frikë, se Kamza e ka filluar integrimin në Evropën e zhvilluar, ka bërë realitet ëndrrën e shqiptarëve për integrim.

Sigurisht nuk mund të lihet pa u përmendur masa jo e vogël e studentëve shqiptarë që studiojnë në Macerata. Në takimet me to gjetëm e pamë emocione të pa përshkueshme. "Jemi krenarë që flamuri jonë kombëtarë valëvitet përkrah atij italian, e kjo mu në mes të qytetit, në fasadën ballore të Bashkisë së Maceratës. Që sot e tutje mendojmë se nuk jemi vetëm"-shpreheshin ato gjithë emocion. Djem e vajza gjithë energji e pasion që bënin një figurë shumë të mirë atje jo vetëm si studentë por edhe me punën

e tyre që zhvillonin për të ndihmuar ekonominë e tyre që të mund të vazhdojnë studimet pa iu rënduar familjeve. Studentë e punëtorë të mirë.

Gjatë të gjithë orëve të ditës e deri në orët e vona të natës, axhenda ishte e parashikuar me takime e vizita nëpër objektet kulturore e administrative të qytetit, të cilët mbanin vlera të veçanta arkitekturore e artistike, vlera të qarta historike, dëshmi e një kulture të vjetër e të ruajtur me kujdes e dashuri të veçantë. Gjeje në muret e këtyre objekteve mjeshtërinë e talentin e rilindasve të mëdhenj italianë, të cilët janë të njohur në mbarë botën. Orë të tëra nevojiten për të parë e shijuar mrekullinë e krijuar prej tyre, për të kuptuar gjenialitetin e tyre të mahnitshëm, të derdhur në mure të brendshme e fasada të jashtme në të gjithë qytetin e vjetër të Maceratës.

Gjithsesi, banorët e asaj zone njiheshin për njerëz punëtorë dhe shumë



Në Ispshkinë e Maceratës



Në Kështjellën e Tolentinos



intervistë

Lidhja e Shqipërisë me Maceratën është që nga viti 1400

Roli i priftit të kishës së Bathores Don Patricio Santineli në lidhjen me Maceratën

Kërkojmë për të mësuar se si lindi kjo marrëdhënie e cila dalëngadalë u shndërrua në një miqësi e cila do të përfundonte me nënshkrimin e marrëveshjes së binjakëzimit. Historia fillon me një vizitë informale të Z Georgio Meschini në Bathore tek miku i vjetër i fëminisë së Don Patricio Santineli, i cili shërben si prift në Kishën e Bathores.

Bisedojmë me Don Patricion në mjediset e Kishës së Bathores.

Ju jeni fillesa e binjakëzimit me Maceratën?

Kështu ka ndodhur, tegon për gazetën "Kamza" Don Patricio, sepse kryetari i Bashkisë së Maceratës erdhi për vizitë në Shqipëri, pasi ne kemi një farë miqësie prej 35 vitesh, që kur ishim fëmijë. Por koha kaloi dhe ne nuk u takuam për një kohë të gjatë, ndërkohë që ai ishte zgjedhur kryetar i komunës së Maceratës. Kur një ditë ne u takuam, Z Meschini preferoj të na bënte një vizitë në kishën e Kamzës, ndërkohë që unë shfrytëzoja rastin që ta prezantoja me kryetarin e bashkisë së Kamzës, ku dhe u hodhën hapat e parë të marrëdhënieve midis këtyre dy vendeve.

Don Patricio kujton: "Kur erdha në fillim në Shqipëri dhe u përqendrova në Bathore nuk e njihja vendin, sigurisht as njerëzit etj. Më duhej një kohë e gjatë për të kuptuar nevojat e këtij komuniteti, ndaj si fillim i kam dëgjuar këta njerëz se për çfarë kishin më shumë nevojë. Ne kemi filluar me ndihmesën tonë ndaj familjeve të varfra, familjeve më në nevojë. Për të realizuar këtë mbështetje kam qenë i lidhur me ca miq të mi në Macerata, të cilët kanë dhënë shuma mujore për të mbështetur familjet në nevojë në Bathore."

Siç shihet marrëdhënia e Maceratas me Kamzën është shumë më herët dhe më e thellë, ajo fillon që me ardhjen e Don Patricios



në Bathore, Kamzë. –Në pamje të parë duket ndoshta sikur unë kam sakrifikuar që jam në Bathore. Kurrësesi, unë kam shërbyer por dhe shumë më kanë dhënë banorët e mrekullueshëm të kësaj zone." Normalisht falë bujarisë së këtij prifti e humanizmit të fesë, bën që nga goja e Don Patricios të dalin të tilla konsiderata të thëna me sinqeritet e dashuri.

Si Don Patricio e ka nxitur marrëveshjen e bashkëpunimit të Maceratës me Kamzën. Si ai ka punuar çdo ditë që të ofrohet dita e nënshkrimit të marrëveshjes së binjakëzimit, që kjo të marrë formë dhe të bëhet tërësisht zyrtare...?

Kemi folur edhe në Macerata për burokracitë që ekziston në çdo vend, ku çdo gjë duhet të jetë brenda rregullave dhe e justifikuar nga baza ligjore. Kjo marrëveshje ka filluar fare spontanisht. Pas vizitës së Georgios

"Rreth 800 student shqiptarë që studiojnë në Macerata. Por duhet të shkojmë edhe më larg. Shqiptarët janë prezent në qytetin e Maceratës që në kohën e pushtimit osman, pas vdekjes së Skënderbeut. Një komunitet jo i vogël me mbiemrin Kraja, është që prej asaj kohe në Macerata. Pra siç e shihni lidhja e Shqipërisë me Maceratën ka qenë që në vitin 1400... Sot kemi edhe studentët që studiojnë në Macerata dhe shërbejnë si vazhdimësi, por duhet të luftojmë të ketë më shumë student nga Kamza që të studiojnë atje. Kjo do të ishte edhe më mirë."

këtu, janë caktuar pikat e referimit për këtë marrëveshje, ku përveç marrëdhënieve miqësore, mes këtyre dy qyteteve janë shkëmbyer edhe disa projekte që Macerata duhet t'i prezantojë së shpejti në Bashkësinë Evropiane.

Si ndihet Don Patricio pas finalizimit të marrëveshjes?

E kam përjetuar shumë mirë, janë momente

zyrtare por të bukura, duke u nisur që nga shkëmbimi i eksperiencave të ndryshme, firmave mes kryetarëve etj, sigurisht që ka edhe momente të tjera që mund të jenë shumë më të rëndësishme se sa kaq. Pasi dy vendet arrijnë të njohin më shumë njëri tjetrin dhe do të krijojnë një farë afrimiteti dhe komunikimi më të drejtpërdrejtë në mes tyre. Unë jam tepër i kënaqur për këtë që ka ndodhur.

Një urë lidhëse ishte edhe Z. Claudio Giuliodori, Ispeshkvi i Maceratës...?

Sigurisht që roli i Ispeshkvi të Maceratës është i madh, pasi për çdo gjë unë i referohem atij. Madje kur ai erdhi këtu në Bathore deklaroi se Bathorja është një vazhdimësi e Maceratës jashtë shtetit italian. Janë marrëdhënie miqësore. Pra të dimë të ecim së bashku, ku është edhe pika më e rëndësishme duke ndarë vështirësitë dhe pasuritë.

Ne folëm për dy ura, ura e parë ishte ju dhe ura e dytë Ispeshkvi. Ura e tretë mendoj se është komuniteti shqiptar që jeton në Macerata dhe kryesisht pjesa e studentëve shqiptar që studiojnë atje?

Po janë rreth 800 student shqiptarë që studiojnë atje. Por duhet të shkojmë edhe më larg. Shqiptarët janë prezent në qytetin e Maceratës që në kohën e pushtimit osman, pas vdekjes së Skënderbeut. Një komunitet jo i vogël me mbiemrin Kraja, është që prej asaj kohe në Macerata. Pra siç e shihni lidhja e Shqipërisë me Maceratën ka qenë që në vitin 1400... Sot kemi edhe studentët që studiojnë në Macerata dhe shërbejnë si vazhdimësi, por duhet të luftojmë të ketë më shumë student nga Kamza që të studiojnë atje. Kjo do të ishte edhe më mirë."-përfundojmë bisedën me Don Patricion.

Bisedoi: Z ELEZI

Flamuri kuq e zi në sheshin kryesor të Maceratës

Bashkia Kamzë më afër emigrantëve në Itali

Shqiptarët e emigruar në Macerata përjetuan një ngjarje shumë të bukur këtë ditë Marsi. Flamuri i Kombit të shqipeve valëviste në sheshin kryesor të këtij qyteti përkrah të atij të vendit mik Italisë. Një atmosferë e mbushur plot emocione dhe kureshtje. Në sallën kryesore të Bashkisë së këtij qyteti rrinin përballë njëri-tjetrit përfaqësuesit e dy bashkive, asaj të Maceratës dhe të Kamzës për t'i dhënë jetë binjakëzimit të tyre. Kjo ngjarje e shënuar u shoqëruar me shumë dashamirësi dhe duartrokitje kur kryetarët e dy bashkive zoti Meschini e zoti Mziu hidhnin firmën për t'i hapur rrugën bashkëpunimit të ndërsjellë në të gjitha fushat ndërmjet qytetarëve të Kamzës dhe atyre të Macerates. Kjo ngjarje shënon krijimin e një ure tjetër në marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë që karakterizon dy vendet tona. Një rol dhe rëndësi të veçantë luan ky binjakëzim edhe për ne qytetarët shqiptarë që prej vitesh jetojmë dhe punojmë këtu në Macerata. Për herë të parë në shumë vite ne ndiejmë nga afër praninë e institucioneve të shtetit shqiptar. Një meritë të veçantë për këtë i shkon grupit përfaqësues të Bashkisë së Kamzës që me këtë treguan të jenë afër jo vetëm qytetarëve të Kamzës, por

edhe emigrantëve shqiptarë në Macerata. Puna e tyre vlerësohet shumë pasi vizioni i tyre nuk kufizohet thjesht në atë të një bashkie vendore, por shkon më tej në integrimin e shoqërisë shqiptare si e barabarte dhe dinjitoze në atë Evropiane. Një interes për këtë binjakëzim shprehën biznesmen dhe tregtarë italianë të pranishëm në ceremoninë e rastit të cilët u ftuan nga të dy kryetarët për të studiuar mundësitë e bashkëpunimit të ndërsjellë edhe në fushat ekonomike.

Mbresa të veçanta vlen të kujtojmë takimin që përfaqësuesit e Bashkisë së Kamzës që patën me përfaqësuesit e shoqatës "ILIRIA" në Macerata. Kjo shoqatë shqiptare e formuar në muajin shkurt të këtij viti nga studente universitare dhe emigrantë nga trevat e Kosovës dhe shqiptarë të Maqedonisë të kryesuar nga Ervin Cakerri nga Vlora. Shoqata e sapo lindur u ideua si një urë integrimi midis emigrantëve dhe italianëve. Ky binjakëzim na krijon kushtet më të volitshme për të punuar së bashku për të arritur ato qëllime, të cilat na bashkojnë.

Takimi i komunitetit shqiptar me përfaqësuesit e Kamzës u karakterizua nga një



atmosferë vëllazërore, duke u mbështetur në traditat dhe zakonet shqiptare. Këtu vlen të kujtojmë këngët e kënduara nga të gjitha trevat shqiptare, duke riafirmuar të qenurit shqiptarë. Kurioziteti të veçanta lindi natyrshëm nga qytetarët italianë, të cilët dëgjonin meloditë me çifteli dhe habiteshin me këta rapsodë të improvizuar.

Urojme që ajo atmosferë e bukur të na shoqërojë edhe në të ardhmen dhe falënderojmë të gjithë stafin e Bashkisë së Kamzës që mundësuan binjakëzimin me bashkinë e Maceratës dhe për mundësitë e reja integruese që na ofron neve emigranteve në Macerata.

EDMOND LEKA



koment

Bashkia Kamzë - një model i hapave integruese evropiane në nivel të qeverisjes vendore

Marrëveshja e binjakëzimit e arritur në 13 Mars 2010 në Macerata të Italisë midis Bashkisë Kamzë dhe Bashkisë së Maceratës, përbën jo vetëm një moment kulmor për sa i përket institucionalizimit dhe ndërtimit të marrëdhënieve bashkëpunuese midis dy qeverive vendore në shtetet fqinjë Shqipëri dhe Itali, por edhe një strategji për përmbushjen e standardeve integruese evropiane në këto nivele. Në radhë të parë, kjo buron nga fakti se Bashkia Kamzë dhe Bashkia e Maceratës, janë dy njësi vendore që operojnë në kuadrin e dy shteteve që aktualisht ndodhen me statuse të ndryshme në raport me Bashkimin Evropian. Kështu Italia përfaqëson një shtet që është pjesë e strukturave të BE, kurse Shqipëria ndodhet jashtë këtyre strukturave, por tashmë ka aplikuar për të fituar statusin e vendit të kandidatit për në B.E.

Për më tepër, përpara vendit tonë tashmë është parashtruar përmbushja e një sërë kriteresh e detyrash, që kanë të bëjnë jo vetëm me politikën e qeverisjes dhe institucioneve qendrore të vendit, por edhe me ato të qeverisjes vendore, reformat që kërkohen të realizohen për të paraprirë procesin të miratimit të Shqipërisë si kandidat dhe mandej si antar i BE. Në këtë kuadër marrëveshjet e binjakëzimit, përbëjnë një instrument mjaft efikas në zhvillimet e sotme bashkëpunuese, që ndihmojnë e stimulojnë përsheptimin e hapave që nevojiten për procesin e integritit evropian, veçanërisht për shtetet si Shqipëria, që synojnë të aderojnë në familjen e përbashkët evropiane.

Është kjo arsyeja që në dokumentin e akt marrëveshjes së nënshkruar nga dy kryetarët e Bashkive të Kamzës dhe Maceratës, të përgatitur nga ekspertët e fushës së marrëdhënieve bashkëpunuese ndërkombe, ka nota të theksuara jo thjesht në aspektin e formalizimit të këtyre marrëdhënieve, por të ndërtimit të hapave institucionale, reformuese, projektuese, ekonomike, politike, shoqërore, kulturore, arsimore, etj, që shkojnë në të njëjtën linjë me ato kërkese e standarde që i ofrojnë dhe i bashkojnë popujt në një familje të përbashkët solidare, paqësore, demokratike, progresiste. Në aktin e marrëveshjes pavarësisht nga statusi, niveli i zhvillimit, pesha, roli dhe kontributi i ndryshëm që kanë qytetet që binjakëzohen, ato janë vendosur në marrëdhënie të barabarta dhe secili në një pozicion kontribuues me mjetet e mundësitë që disponon, kapacitetet, burimet e aftësitë reale egzistuese të sotme dhe të së ardhmes, për të shprehur e realizuar në mënyrë konkrete vullnetin e dëshirën e komuniteteve përkatëse, por edhe shkëmbimin e arritjeve në fushën e njohurive aplikuese e të teknologjive të përparuar bashkëkohore.

Natyrisht për të arritur në këtë moment deciziv, për të hartuar e nënshkruar një dokument integral bashkëpunimi dhe progresi, leadershipit e stafit mbështetës të Bashkisë Kamzë ju desh një periudhë prej gati dy vjetësh, që mund të quhet pa mëdyshje periudha e provës për besueshmërinë e vlerësimin e marrëdhënieve të ndërsjella me Bashkinë e Maceratës, për seriozitetin e korrektesinë për t'ju përgjigjur në kohë dhe me axhendë konkrete kërkesave dhe çështjeve me interes dy palësh, por edhe shumë planësh. Sidomos



në këtë linjë u zhvillua një korrespondence intensive dhe u shkëmbyen informacione njohëse, ide dhe propozime, të cilat konvergjuan drejt një akti binjakëzimi me dimensione dhe komponentë gjithëpërfshirëse, që sigurojnë e garantojnë një bashkëpunim afat gjatë dhe impakt të dukshëm pozitiv për komunitetin. Të dy palët gjithë diskutimin dhe procesin përgatitor të arritjes së aktit final të binjakëzimit e orjentuuan me tendencë themelore, **si të bashkëpunojmë që të ecim në përmbushjen e kërkesave të Bashkimit Evropian, që mbështet nismat dy palëshe e shumë palëshe për projekte zhvillimi me bazë e lokale, rajonale e më gjerë.**

Në këtë kuadër dhe për t'ju përgjigjur sfidave të reja, Bashkia Kamzë fillimisht nënshkroi "Marrëveshjen e Mirëkuptimit" me Bashkinë e Maceratës. Kjo Marrëveshje e kishte bazën juridike në akte e konventa të ndryshme ndërkombëtare, kombëtare dhe rajonale, të cilat lidhen me kujdesin ndaj komuniteteve, e në mënyrë specifike, bazohen tek udhëzimet e Bashkimit Evropian dhe të Komisarariatit të Lartë të Kombeve të Bashkuara. Në mënyrë të veçantë, nëpërmjet këtij akordi synohej të eksperimentohej një model ndërhyrës integrues që parashikojnë përfshirjen e operatorëve publikë e privatë dhe të burimeve aktive në territorin Shqiptar dhe të Rajonit Marke, me qendër Maceratën, si një Rrjet Bashkëpunimi, me qëllim promovimin e veprimtarive të zhvillimit ekonomik e mjedisor, të formimit, mbështetjes mes administratave dhe në mënyrë të veçantë të evidentimit për ndërhyrje të zgjidhjeve të problemeve të mprehta sociale.

Po kështu parashikohej ndërmarrja e një sërë iniciativave formimi, informimi dhe sensibilizimi, të cilat shtrohen si nevojë e rritjes dhe zhvillimit të realitetit shqiptar, iniciativa të informimit dhe formimit për personelin administrativ e teknik të Bashkisë, me qëllim përmirësimin e kapaciteteve të administratës lokale, të planifikimit e administrimit të mirë ekonomik financiar, human, territorial dhe për parandalimin e risqeve të keqpërdorimit të fondeve publike, të promovimit të iniciativave të zhvillimit dhe shkëmbimit ekonomik ndërmjet bizneseve.

Gjithashtu synohej përfshirja dhe bërja aktive e subjekteve publike dhe private në territorin shqiptar, të cilët punojnë në fushën sociale, ngritja e një grupi studimi të përbashkët ndër-institucional, i cili të realizojë një studim kërkimor e projektues mbi problematikat sociale dhe nevojat prioritare, përgatitjen dhe realizimin e moduleve për formimin dhe informimin, të cilat kanë për qëllim të evidentojnë problematika sociale, pasojat e sjelljeve përjashtuese e abuzive dhe realizimin e ndërhyrjeve të donacioneve eventuale humanitare.

Bashkia e Maceratës, si një bashki e përparuar e një vendi të BE, garanton bashkëpunimin dhe mbështetjen duke vënë në dispozicion, në bazë të rregullave dhe normave në fuqi, burimet humane të Institucionit, në varësi të kompetencave dhe profesionalizmit specifik, instrumentet, të dhënat dhe eksperiencat e përfuara gjatë aktivitetit të saj në sektorin e zhvillimit ekonomik dhe të bashkëpunimit, si edhe do të mbështesë përfshirjen, formimin dhe informimin e qytetarëve shqiptarë, të cilët banojnë në territorin e kësaj Bashkie, nëpërmjet iniciativave të integritit dhe bashkëpunimit me Bashkinë e Kamzës.

Në zbatim të marrëveshjes u organizuan një varg negociatash e vizitash të ndërsjellta, ku u identifikuan nevojat prioritare dhe fushat e bashkëpunimit, duke patur parasysh ato që garantojnë e sigurojnë resurse për zhvillim, por edhe ekspertizën e nevojshme për implementim. Në këtë kuadër janë diskutuar e hartuar projektet e përbashkëta që mundësojnë edhe mbështetje financiare nga burimet rajonale, por edhe ato që kanë të bëjnë me mbështetje të programeve të financuara nga Komuniteti Evropian, siç është programi i vendeve rajonale që lagen nga Deti Adriatik, pra programi IPA, pa lënë pas dore edhe projekte që lidhen me investimet e biznesit italian në zonën e Kamzës. Është kjo arsyeja që struktura e koordinimit dhe projekteve me BE të rajonit Marke, ka krijuar një eksperiencë bashkëpunimi edhe me Shqipërinë, veçanërisht me zona turistike e kulturore si Vlorë, Gjirokastra, etj, dhe tashmë është e gatshme të mbështetë në strukturat e BE, edhe projektet e përbashkëta të Maceratës dhe Kamzës, si edhe qyteteve të tjera nga Shqipëria, Mali i Zi,

Maqedonia, Bosnja, etj, duke krijuar kështu një spektër të gjerë bashkëpunimi e integriti, në nivel lokal e rajonal.

Një rol të rëndësishëm në këtë proces integruar ka edhe komuniteti shqiptar që jeton e punon në vendet e rajonit. Të tilla ka edhe në Macerata, që reshtohet në vendin e tretë, ndër komunitetet që jetojnë në këtë qytet, madje edhe me një histori të hershme, ku ndër vendbanimet më të vjetra të këtij qyteti janë edhe ato të shqiptarëve të ardhur që nga koha e Skënderbeut dhe që kanë dhënë kontributin e tyre për zhvillimin e këtij qyteti me histori dhe kulturë të spikatur evropiane. Por në kohën e sotme, në një nga universitetet më të vjetra të Italisë, në Macerata, studiojnë edhe një grup të rinjsh shqiptarë, të cilët po krijojnë edhe një bërthamë aktive, për tu përfshirë jo vetëm në jetën akademike e kulturore të qytetit e rajonit, por edhe në atë shoqërore. Kjo është një tjetër aspekt që e bën marrëveshjen e binjakëzimit edhe më të favorshme, sepse do t'i japë shtytje bashkëpunimeve të moshave të të rinjve universitare e para universitare shqiptarë dhe italianë, për të krijuar lidhje të afërta e shkëmbyer eksperiencat në fusha të ndryshme të dijës e kulturës.

Natyrisht në këto marrëdhënie binjakëzuese Bashkia e Maceratës është ajo që të do të ketë rolin e promotorit, për përmbushjen e detyrimeve e reformave të nivelit lokal e rajonal, që rrjedhin nga procesi i integritit, si edhe atë për udhëheqjen e projekteve që do të aplikohen nga palët në zbatim të strategjisë së zhvillimit të Kamzës.

Nga ana e saj Bashkia Kamzë është në stadin më të mirë në të gjithë historinë e vet, ku ka krijuar infrastrukturën institucionale të domosdoshme për t'ju përgjigjur kërkesave të partneritetit dhe integritit evropian, si: në hartimin e strategjisë afat mesme të zhvillimit, pra 2008-2015; finalizimin e studimit urban të qytetit; ngritjen e mekanizmave bashkëkohore për shërbimin ndaj qytetarëve e biznesit, siç është Qendra "One Stop Shop", projektet e vazhdueshme për infrastrukturën rrugore; studimin e fizibilitetit për ujësjellës kanalizimin për të gjithë Kamzën, projekti në zbatim për ndërtimin e pallatit të kulturës; projektet për shkollat e reja; studimi për menaxhimin e mbetjeve urbane; bashkëpunimi i ngushtë me Qendrën e Biznesit; projekti për ngritjen e Qendrës së re Profesionale; projekti antikorrupsion, projekti i Qendrës Sociale, etj. Kjo ka bërë që Bashkia e Kamzës të ketë krijuar partneritete mbështetëse të institucioneve ndërkombëtare si KE, OSBE, Banka Botërore, Bashkia e Jenës Gjermani, Dhoma Tregtisë Argjentinë Shqipëri dhe Bashkia e La Platës Argjentinë, Ambasadat Gjermane, Holandeze, Japoneze, Suedeze, etj, Kompania AMC, si edhe kompanitë lokale, Bankat, etj.

Është e kuptueshme që në këtë rrjet bashkëpunimesh që vjen duke u zgjeruar pandërprere, Bashkia Kamzë gjithnjë e më shumë jo vetëm që hedh hapat e sigurta të zhvillimit të qytetit, duke krijuar një vazhdimësi ndryshimesh të dukshme e të prekshme, por edhe kontribuon në vënie në jetë të programit të Qeverisë për realizimin e integritit në Bashkimin Evropian.

RAIMOND PENGU
Drejtor i koordinimit zhvillimit



bashkëpunim&sport

Banka Botërore së shpejti do të fillojë ndërtimin e dy shkollave në "Bathore 5" dhe "Bathore 6"

KAMËZ, 18 dhjetor 2010 - Bashkia e Kamzës priti në një takim përfaqësues të Bankës Botërore si dhe përfaqësues të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës. Në këtë takim u diskutua për investimet që Banka Botërore do të bëjë në drejtim të arsimit, pikërisht në ndërtimin e dy shkollave të tjera, përkatësisht "Bathore 5" dhe "Bathore 6".

Gjatë këtij takimi u diskutua për sheshet e ndërtimit, të cilat aktualisht është bërë transformimi i pronësisë, bashkisë Kamëz dhe pritet që brenda pak ditëve të merret leja e ndërtimit.

Me të njohur me situatën që kryetari i Bashkisë së Kamzës z. Xhelal Mziu i bëri të ditur përfaqësuesve të Bankës Botërore z. Daniel Gross për këto dy sheshe, ky i fundit i premtoi z. Mziu që së shpejti do të fillojë ndërtimi i këtyre dy shkollave brenda të gjitha standardeve evropiane.



Ekipi Kamza sjell emocione në fushë

Kamza barazon 1-1 me Partizanin

Është luajtur java e 22-të e kategorisë së parë, e cila ka dhënë mjaft rezultate surprizë. Ndryshe nga superliga, kjo kategori po prodhon emocione, luftë të fortë sportive dhe enigma të pafund, përjashtoj Bylisin, që e ka "pronësuar" që nga fillimi i garës vendin e parë. Në kuadrin e kësaj jave, në këtë kategori, binte në sy ndeshja Kamza-Partizani, njëloj derbi mes këtyre dy skuadrave. 90 minuta plot emocione, të përcjella nga rreth 5 mijë tifozë në Kamëz, e cila ia ka ndarë skuadrat me nga një pikë, falë barazimit 1-1.

Të parët kanë kaluar në epërsi vendasit, e drejtuar nga ish-portieri legjendë i Partizanit, Perlat Musta, me anë të durrsakut Edlir Tetova, në fund të pjesës së parë. Me nisjen e pjesës së dytë ka barazuar Partizani, me anë të mbrojtësit Sheta. 45 minutat e dyta kanë folur për të kuqtë, që kanë rrezikuar disa herë portën e Osmanit, por nuk kanë realizuar dot, sa për meritë të "gardianit" të Kamzës, aq edhe për nxitim dhe mos përqendrim të sulmuesve të kuq. Në këtë mënyrë, kjo ndeshje, e pritur me mjaft interes, është mbyllur në barazim 1-1, duke mos i kënaqur të dyja palët, pasi një pikë sikur nuk i bën punë asnjërës. Po të kemi parasysh faktin se rivalët e tjerë, që mëtojnë superligën, kanë fituar: Bylisi, i pandalshëm në këtë kampionat, ka mundur 4-1 Bilisht Sportin, në Ballsh, Lushnja

ka triumfuar pa shumë vështirësi, 3-0, ndaj Memaliajt në "Roza Haxhiu", ndërsa Elbasani ka dalë me një barazim të bardhë 0-0 nga transferta e vështirë e Velipojës, me Adën vendase.

Goleadë ka realizuar Turbina e Cërrikut, në ndeshjen që luajti në shtëpi me Gramshin. Fitorja 5-0 tregon supremacinë e cërrikasve në këtë ndeshje, aq sa ka "korrur" edhe Luftëtarin në sfidën e luajtur në Gjirokastrë, ndaj Sopotit.

Fitore minimale 1-0, por që ka vlerën e 3 pikëve, ka marrë Besëlidhja në shtëpi ndaj Skraparit, ndërkohë që të dielën u luajt ndeshja e fundit e kësaj jave, pikërisht në Korçë, mes Pogradecit dhe Burrelit, ku liqenoret e Pogradecit fituan 1-0 me Burrelin..

KLASIFIKIMI KATEGORIA I

Renditja e Kategorisë së Parë pas javës së 22-të

1.	BYLIS	57 PIKE
2.	ELBASANI	43 PIKE
3.	LUSHNJA	43 PIKE
4.	ADA	38 PIKE
5.	KAMZA	38 PIKE
6.	PARTIZANI (-1)	36 PIKE
7.	POGRADECI	36 PIKE
8.	LUFTETARI	29 PIKE
9.	BILISHT SPORT (-2)	27 PIKE
10.	GRAMSHI	24 PIKE
11.	BURRELI (-2)	22 PIKE
12.	BESELIDHJA	21 PIKE
13.	TURBINA	19 PIKE
14.	MEMALIAJ	17 PIKE
15.	SKRAPARI (-1)	17 PIKE
16.	SOPOTI (-1)	11 PIKE



NJOFTIM

Bashkia Kamez njofton të gjitha subjektet e interesuara se me datë **31.03.2010, ora 11.00** bëhet vlerësimi i ofertave që do të paraqiten për paisje me liçense për transportin e udhëtarëve në linjën ndërqytetëse.

KAMËZ - BULQIZË - KAMËZ

Informacion më të hollësishëm, mund të merrni pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Bashkia Kamëz.

Pranimi i ofertave do të bëhet deri më datë 31.03.2010 ora 11.00